



E DIEL
29 Janar
2017

MILOSAO

e-mail: milosao2005@yahoo.com

Formula e Mallkimit

"Synimi i studimit tim mbi këtë formulë, që ngérthen kreun e parë të monografisë, është në radhë të parë njohja e saj në diskursin intelektual shqiptar si dëshmia e dytë më e hershme në gjuhën shqipe (1483). I ka anashkaluar këtij diskursi, edhe pse është zbuluar qyshtë fillim të viteve '70 të shekullit të kaluar. Dhe arsyja është e thjeshtë, më saktë fare banale: bashkëzbuluesi i saj ishte Martin Camaj (krahas Ludëg Braun), veprat e të cilit ishte vënë me kohë në indeks dhe formula vetë kishte veshur me kohë pluhur e harresës historike në diskursin intelektual shqiptar. Këtë synim e shoqeron gjithash-tu interes filologjik. Teksti i është nënshtruar analizave të mirëfillta filologjike, duke ardhur natyrshëm në përfundimin, që informanti duhet të ketë qenë pas gjithë gjasash një arbëresh i ngulimeve të Sicilisë".

Prof. Bardhyl Demiraj

ARBËRESHËT kyçi ynë i gjuhës

Gjallesa e një areali kulturor arbëresh të mirëfilltë, qysh në fillesat e veta, në shekujt e mbramë të Mesjetës (XV-XVIII) vazhdon e jep në vazhdimesi ndihmesë të vyer në formëzimin dhe ngjizjen e mendimit intelektual-albanologjik shqiptar. Madje nuk gabojmë aspak po të mëtojmë sot që një vatër të parë në debatin e mirëfilltë intelektual-albanologjik e kërkojmë dhe e gjejmë pikërisht në këtë areal në gjysmën e parë të shekullit XVIII, shprehet autor...

Meshari, një enigmë e madhe

"Meshari" silkurse vetë autor i tij, biri i Bdekës, mbeten sot e gjithë ditën një enigmë e madhe në historinë e kulturës shqiptare. Kohët e fundit është marrë intensivisht me këtë problem kolegu dhe miku im dr. Joachim Matzinger (2010/11) e sidomos studiuesja serioze Lucia Nadin (2012). Të dy vijnë në përfundimin se vendndodhja e Buzukut, përkatësisht vendi i botimit të "Mesharit" do kërkuar jashtë hapësirës kompakte shqipfolëse, pa gjasa në Venecia. Pa dashur të vë në pikëpyjetë ndjenjat atdhetare të Buzukut, lejohem gjithsesi të pikëpyes të paktën vendin e botimit të "Mesharit" në hapësirën kompakte shqipfolëse, meqë atëbotë nuk ekzistonin kushtet çfarëdo për realizimin e një botimi të tillë. Nga ana tjetër nuk kemi arsyë të vëmë në dyshim që kopje të këtij libri të kena qenë qarkulluar në radhët e klerit shqiptar në Shqipëri, Kosovë e gjetkë. Të mos harrojme se edhe autore të mevonshem botimesh shqip si Budi, Bardhi, Bogdani, Kazazi, Radovani, Guagliata, Basile, Radoja, Logoreci etj. i janë drejtuar Itali, kur kanë dashur të batojnë dhe kanë botuar po aty veprat e veta. E destinacioni ka qenë gjithsesi në tjetër drejtësim: areali kulturor i Veriut katolik shqiptar".

I INTERVISTË

Gjallesa e një areali kulturor arbëresh të mirëfilltë, i cili qysh në fillesat e veta, në shekujt e mbramë të Mesjetës (XV-XVIII) vazhdon e jep në vazhdimesi ndihmesë e vyer në formëzimin dhe ngjizjen e mendimit intelektual-albanologjik shqiptar. Madje nuk gabojmë aspak po të mëtqjmë sot që një vatër të parë në debatin e mirëfilltë intelektual-albanologjik e kërkojmë dhe e gjejmë pikërisht në këtë areal në gjysmën e parë të shekullit XVIII, shprehet autor i...

Kultura e shkrimit në ngulimet arbëreshe të Italisë, thesari ynë i gjuhës

Intervistë me prof. Bardhyl Demiraj, drejtuesin i katedrës së albanologjisë në Universitetin Ludwig-Maximilian të Mynihut. Si erdhi libri me studimet filologjike "Gjak i shprishur" dhe shumë shpjegime lidhur me tezat e tij... Areali arbëresh, qfarë i detyrohem, pse ka luajtur rol të jashtëzakonshëm për kulturën kombëtare dhe shumë e shumë argumenta të tjera

INTERVISTOI BEN ANDONI

Elementi i parë që ngërthen lexuesin e kësaj interviste është shqipja e mrekulueshme e përdorur nga profesor Bardhyl Demiraj. Drejtuesi i katedrës së albanologjisë në Munih, nuk mjaftohet vetëm me shpjegimin e përgjithshëm të librit të tij, por na sjell një varg shpjegimësh lidhur me Buzukun, Formulën e Mallkimit, kuptohet shumë e shumë individiv të shqar arbëreshë, por edhe shpjegime të thukëta për probleme albanologjike që lidhen me arealin arbëresh e shumë e shumë të tjera. Intervista shijojet për një publik mbasë jo të madh, por i bën ndër "Milosao"-s në genësinë e saj... Urojmë që z.Demiraj ta kemi më shpesh në fajet e "Milosao"...

Libri me studimet tuaja filologjike "Gjak i shprishur" ka pak kohë që është përfshitur në librin e gjithë publikun shqiptar. Ai ka në fokus arealin arbëresh kurse tezat që e përshtojnë atë janë realistë intersantë për një lëmë të tjërë studiuesh.

Cila është lidhja juaj si studiues me arbëreshët dhe shkollat e tyre?

"Lidhja është në fakt e disafishtë, por mund të kufizohem në radhë të parë me profesionin tim si historian dhe filolog i gjuhës shqipe. Si i tillë janë i interesuar drejtëpërdrejt në njohjen dhe hulumtimin e asaj larmie varianteash gjuhësore që përjeton kjo gjuhë kudo dhe kurdo, ku dher kundër sot ose përdorej dikur si mjet komunikimi brenda bashkësise. Shqipja e folur dha kultura e shkrimit shqip në diasporën historike shqiptare, sidomos në ngulimet arbëreshe të Italisë janë vërtejt një thesar në hulumtim, sepse lejnjë induksionin në themë, që vjen me thënë në rindërtimin historik të fazave të ndryshme evolutive që ka përjetuar shqipja e folur dhe e shkuar në kohë e hapësirë, e bashkë me të sigurisht edhe mendimi intelektual shqiptar si pjesë e pandarë e matraksit të kulturës etniqi-gjuhësore shqiptare. Si shembull klasik më lejoni të përmend emrin e profesor Egrem Çabej, i cili jo rastësisht e filloj aktivitetin e tij intelektual-albanologjik pikërisht duke promovuar



me një temë me fokus të folmen e arbëreshëve të Horës në Sicili.


Një lidhje të dytë, po aq të fortë, e senderton ndërkohe vendi i punës dhe institucioni ku unë punoj si drejtues i katedrës së albanologjisë në Universitetin elitar Ludwig-Maximilian të Munihut. Bashkëpunimi i ngushtë me disa gendra albanologjike të Italiane e Jugut, si p.sh. në Cosenza, Palermo e Napoli, kurse edhe zhvillimi i eksperimentave gjuhësore-etnologjike me studentet në terren janë pjesë e asaj tradite të mirë që nxiti dha mbarështoi dikur, qysh në vitet 60' të shekullit të kaluar, themeluesi i kësaj dege, albanologu e shkrimtar i njohur Martin Camaj".

Cfarë mund të zbulojë për historinë e filologjisë shqiptare hulumtimi i vazhdueshëm te arbëreshët?

"Është gjaku ynë i shprishur, i shpërndarë, d.m.th. pjesë e pandarë e entitetit tonë kulturor. Shumëkush e vështron sot kulturën e shkrimit shqip si njëri ndër identifikatorët e kulturës etniqi shqiptare, e cila as që mund të konceptohet më së i tillë pa prurjet specifike dhe në vazhdimësi të kulturës arbëreshe. Sigurisht që do të ishim të paplotë, sikur ta kufizonim radosin e kërkimit

Formula e Mallkimit

Synimi i studimit tim mbi këtë formulë, që ngërthen kreun e pare të monografisë, është në radhë të parë njohja e saj në diskursin intelektual shqiptar si deshmi e dytë më e hershme në gjuhën shqipe (1483). I ka anashkaluar këtij diskursi, edhe pse është zbuluar qysh në fillim të viteve '70 të shekullit të kaluar.



tonë filologjik vetëm në mbledhjen, njohjen dhe përpunimin e materialit gjuhësor dhe etnografik arbëresh, të fiksuar në tillë në shkrim apo të mbledhur drejtëpërdrejt në terren. Kjo është vetëm njëra anë e medaljes e për këtë kanë hyrë ndërkohe dorëzanzë me kompetencën e duhur qendrat albanologjike në Cosenza dhe Palermo. Sot kemi më fort të drejtë të flasim për gjallesën e një areali kulturor arbëresh të mirëfilltë, i cili qysh në filletë e veta, në shekujt e mbramë të Mesjetës (XV-XVIII) vazhdon e jep në vazhdimësi atë ndihmës të vyer në formëzimin dhe ngjizjen e mendimit intelektual-albanologjik shqiptar. Madje nuk gabojmë aspak po të mëtqjmë sot që një vatër të parë në debatin e mirëfilltë të intelektual-albanologjik e kërkojmë dhe e gjejmë pikërisht në këtë areal në gjysmën e parë të shekullit XVIII".

Sa ndihës është kontributi i arealit kulturor arbëresh përpjeksh që shkruar në kahun jetët të Adratiqit?

"I madh, shumë i madh. Megjithatë, vetëm një pjesë të vogël të kësaj ndihmës e ngjerojmë ndërkohe në do tekste shkollore e vademekume akademike zyrtare të natyrës së "Fjalor Enciklopedik Shqiptar" (FESH, Tiranë I 1985; II

2008/9), e kryesisht kur bëhet fjalë për rolin e këtij areali në zhvillim që përjetoi lëvizja kulturore-ideologjike e Rilindjes Kombëtare Shqiptare në gjysmën e dytë të shek. XIX. Ajo që mabetot sot për t'u përditësuar në botimë të kësaj natyre është periudha e ashtuquajtur "Rilindje para Rilindjes", si e kanë pagëzuar diku me të drejtë kolegët dhe miqtë e mi Francesco Altimir i dbe Matteo Mandala. Kjo periudhë përkon në kohë me ndryshimin e paradigmës që përjetoi mendimi intelektual-albanologjik gjatë shek. XVIII në dy qendrat e formimit intelektual-fetar në arealin kulturor arbëresh, siç janë Collegio Corsini në San Benedetto Ultano (1732) e sidomos Seminario Italo-Albanese në Palermo (e më pas në Horë të Arbëreshëve të Sicilisë), i themeluar më 1734 nga At Gjergj Guxeta".

A mund të na shpjegoni diçka për kontributin e Seminarit Arbëresh të Palermos dhe realistikët kontributin e tij për albanologjinë në shekufit?

"Është një pyetje që e prisja në fakt. Mjafiton të mbajmë parashys që këtij seminar i është kushtuar në FESH një zë lillup me gjithëgjithë 8 rreshta të një kolone, të cilat në fakt nuk kumtojnë asgjë, ndërkohe që emri i themeluesit të tij, ai i At Gjergji Guxetës (= <Padre Giorgio Guzzetta>), nuk figura gjekundi. E për të krijuar një idë më të qartë lidhur me proporcione që fitojnë zërat enciklopedikë sidomos në robitimin e dytë të FESH-it, mund të sjellim në përgjasje zérin enciklopedik me plot 41 rreshta që i përkushton vete të redaktori përgjigjetës i këtij botimi (II 2008, f. 1448-9; Lafe, E.), i cili gjellin ende midis nesh e gëzon shëndetë të plotë.

Prashtu po përbëhet sado thukët, që kjo seminar i përfshinë në një periudhë, kur intligencja dhe kleria arbëresh ishin njëherës në kërkim dhe në mbrojtje të vvetves të përfaqësues të një entiteti etnik-kulturor të veçantë, i cili dallohej qartas në mëdisin sicilian të kohës jo thjesht dhe vëtëm me arbërishten si mjet komunikimi brenda bashkësise, por edhe falë identifikatorëve të tjera themelorë në matriksin e kulturës etnike arbëreshe, si p.sh. origina, kujtesa historike dhe tradita e ndryshme jetësore lidhur me doket, zakonet



...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri i bëhet realizuar me argumentin kryesor në ndihmë të korpusave gjuhësore. Profesor Rami Memushi, në kuadër të një konference ndërkombëtare në Rusi, iu referua kësaj përvjoje bëtoretë të punës me korpuse, e përcollin në formën e një apeli nevojë që ngushtime që në institutet tonë të gjuhësise, të paktën në Tiranë dhe në Prishtinë, të mendohet seriozitë për një korpus elektronik me të plotë të gjumurë shqipe, që do të ishte një "kartotekë moderne" dhe e përdituese shume shumë e pasur se kartoteka e vjetër e Institutit të Gjuhësës në Tiranë, e cila do të shërbejë për studime gjuhësore dhe për hartimin e fjalorëve të ndryshëm të shqipes. Për këtë merrej si bazë

korpusi i studiuesit Kabashi, që, për madhësinë e dhue për gjersine e informacionit, eshte vleruar. Z. Kabashi është kontakti i redaktorit dhe vendlodës një lidhje që edhe Milosao të futej në të ardhmen në shqyrtimin e këtij korpusi. Ishte një shenje rire.

Avgi Alcani na kish sjellë përvjojen e frankofonisë në një fshat shqebasias. Ishte pak patetik si shkrimi, por autor duhet vlerësuar për respektin e tressës së tij. Bérzeshtanakët e parë kanë qenë shikoliar gjatë shek. të 19-të të kryeqytetit e Perandorisë otomane, në Universitetin e Stambollit, i cili ishte themeluar në vitin 1846, referoi ai.

Meri Lalaj na kish sjellë një përkthim interesant nga Amanda Haight. Një episod i jashtëzakonshëm takimi i Filotheo Xasi të Berlinit, që per-

sonalitetevë të mëdhenj: Ata biseduan tok për shumë gjëra, njësiz e përbashkët që njihnin shumë prej të cilave, si përmes Salomea dhe Aleksandr Halperin, përmët e Ahmatova prej shumë e shumë vitesh nuk kushtë dëgjuar asnjë fjalë – për Gumiživin, Louné, Shilejkon, Pastëmekun dë Mihail Llozinskin, të cilët ajo i shprehur. Puninin, që banonat në derën e dhomës tjetër mezi e përmendën. Ahmetova fliste menjënjë për Boris Antrepin dhe Marina Cvetajevën. Nuk i bënte zemra të fliste për Mendelssohnin. Tragjedia e burgut dhe e vdekjes së tij ishin aq pranë. Duke u përpjekur të thotë dikë përfshirë heurë në lot.

Vete Redaktori shtoi ditëqë për romanin e Stefan Çapalikut. Eshët pak e veshtrirë ruajta e

regjistrat të romanit autobiografik me syrin e një femije, ndaj autorin i tui i uli nga lura e tere ferrigeja e tij rrëtë pa mosha. Ndërkohë që mund të ishte pak më naiv. Nga ana tjetër, Çapaliku mund të justifikohet me të drejtë pasi që masë interesante ngjarësia që ka nuk e mban dot perceptimin e një femje dhe ndaj e shndërrohet shpesh. Rrëfimi i autorit në këtë roman eshtë gjithsesi interesant, pak i padisiplinuar disa herë, por me sa duket i duhuri për këtë thesar, që lashme ai e ka nxjerë... Duket se shkrimi i redaktorit nuk u pëlqye sepa autor i mjaftua me një Faleminderit shumë të thatë. Numri ishte relativist i mire por pak si i tejkular me trajasat e tij, mendon redaktori.



e mënyrën e jetesës, deri edhe dalimet në besimin kristjan, përkatësisht në ushtrimin e rritti ortodoksbizantin. Andaj nuk kemi përsë bëjmë aspak çudi, që themelimi i këtij seminari, i cili – siç edhe pritej – kishte për qëllim kryesor përkujdesjen dhe mbarështimin e ritit dhe të formimit të klerit arbëresh, u shqoqrua me përshtatjen dhe zbatimin e një projektit afatgratë kërkimor-shkencor, duke u sendërtuar si i tillë qysh në shek. XVIII në debatin intelektual-albanologjik dhe për rrjedhojë ravijëzuar konturet e albanologjisë si fushë komplekse rajonalë".

A mund të sqaroni shkurt rolin e At Gjergj Guxetës në këtë kontekst?

"E kam shumë të vështirë të portretizoj thukët këtë figurë shumëdimensionale e sidomos të përshtuara ato dhunti të pazakonshtime që e përcollën këtë kolos të gjakut tonë të shpërshir qysh në gjallje të vet drejt kupoletës së mendimit intelektual shqiptar-arbëresh të gjitha kohërat. Po përmend se pari karizmën dhe angazhimin social që e shqoqruan gjithë jetën klerikar arbëresh, sa i përkert ruajtjes dhe mbarështimit të identitetit etnik-gjuhësor në ngulimet arbëreshe në Sicili, një angazhim që arriti vërtet një pikë kulmore, kur përfjetoi në gjallje që vet iderimin mbarëarbëresh si *Apostolo degli Albanesi della Sicilia*. Parë nga kjo perspektivë nuk kemi përsë bëjmë tash aspak çudi, përsë korpi i At Gjergj Guxetës është i pari dhe i vetmi në historinë e kulturës shqiptare-arbëreshës që përfjetoi mumifikim pas vdekjes, duke e shndërruar kështu vetë Kishën Katedrale të Eparkisë së Horës së Arbëreshëve të Sicilisë vend pelegrinazhi të përhershëm. Lidhur me aktivitetin

e tij intelektual-albanologjik do të ishë i paplotë po të përshtatja vëtëm rolin e tij si ideator dhe përpillues i atij programi ballor e afatgratë të kërkimit shkencor që preka ma lart, në mos të citojë edhe atë aradhë i thirrshët (*María Parrini, Zef Skiröi (prosenior), Nikollë Keta, Nikollë Filia etj.*) që e vunë në jetë atë program, duke krijuar këshut një traditë të mirë të shëndetshme në debatin intelektual shqiptar-arbëresh që shkejti e mëvonshëm. Shumë më domethënës është gjithsesi ai simbol themelor në kulturën tonë mbarekombëtare, që trashëgojimë pikërisht preri pendës që tij: bashshkronja <– me ato dy pikat

thotë realist kjo?

"Që ta ndërtidh këtë pyjetje me atë të bërë më sipër, ne e njihnim deri sot Imz. Kazazin si dëshmitarin e parë kompakt i "Mesharit", meqë ai, pas gjise, jo rastështë mëngoli t'i kumtonte këtë "zbulum të madh" pikërisht. At Gjergj Guxetës, duke kopjuar me dorë edhe kolofonin e ndonjë pasazhi tjetër nga ai libër. Kësaj rrëthane i kemi kushtuar që të veçantë se studimin tonë, duke mundur të përmirësojmë krologjinë e "zbulumit" me tre vjet, pra në vitin 1713 dije që më 1740 siç mëtohet deri sot (sh. FESH I/VII). Krejtësi e dokumentacionit arkivor i Eparkinës e Horës së Arbëreshëve si edhe botimi i veprës në

dorëshkrim të At Nikollë Ketës (= "Padre Niccolo Chetta") na cojne natyrshëm në përfundimën e vepra e Buzukut njihet edhe para vitit 1740, të paktën kur ndodhet në bibliotekën e Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s në Romë. Një ndër këta lekues ka genë edhe Imz. Filotheo Xasi (= "Msgr. Philitoe Xassi") që kaloi vitet e fundit të jetës se vërtë në Rome (1716-1726) e të cilin i kemi kushtuar gjithashtu një krye më vete në punimin tonë. Bashkëpërkimet e qëmtuar gjatë analizave filologjike të teksteve shqip të Kazarit me ato të arbëreshit bashkëkohës Imz. Zef Skiröi prosenior (= "Msgr. Joseph Schiröi") lejojnë gjithashtu të deduktojmë natyrshëm ndërlidhjen e dashkëjështës me mendimin intellektual shqiptar-arbëresh ndërmjet dy arealev kulturore në këtë periudhë, të cilin e pagëzojmë me të drejtë si Rilindjes".

Ka një referim nga kolegët tuaj italiandarë "Meshari" është përgatitur në Itali dhe kurrë s'ka kaluar në territorin tonë. A mendoni dñe Ju që libri i të mos e ketë kaluar kufurin e sotëm të Italisë gjatë kohës kur është shkruar?

"Unë si filolog jam mësuar të punoj me fakte e, kur s'i kam, i kërkoi ato, përpëra se të vij në argumentime pozitive. "Meshari" i sikurse vëtë autorit i tij, bëri i Bëkës, mbeten se gjithë ditën një enigmë e madhe në historinë e kulturës shqiptare. Kohët e fundit është marrë intensivisht me këtë problem kolegu dhe miku im dr. Joachim Matzinger (2010/11) e si domos studiuesja serioze Lucia

"Meshari", një enigmë e madhe

"Meshari" i sikurse vëtë autorit i tij, bëri i Bëkës, mbeten sot e gjithë ditën një enigmë e madhe në historinë e kulturës shqiptare. Kohët e fundit është marrë intensivisht me këtë problem kolegu dhe miku im dr. Joachim Matzinger (2010/11) e si domos studiuesja serioze Lucia Nadin (2012). Të dy vijin në përfundimin e vendndodhja e Buzukut, përkatesisht vëtë i bominit të "Mesharit" do kërkuar jashët hapësirës kompakte shqipfolëse, pas gjise në Venedig. Pa dashur të vë në pikëpyetje ndjenjat atdhetare të Buzukut, lejohem gjithsesi të pikëpërfshirës të paktën vendin e kësaj qyteti që nuk e kishte qëndruar që të gjithë tilla. Ngana tjetër nuk kemi arsyë të vëmë të dyshim që kopje të këtij libri i keni qarkulluar në radhët e klerit shqiptar në Shqipëri, Kosovë e gjetje. Të mos harrojmë se edhe autorë e mëvonshëm bëhet shqip si Budi, Bardi, Bogdani, Kazazi, Radovani, Guagliata, Basile, Radoja, Logoreci etj, i janë drejtuar Italisë, kur kanë dashur të botojnë dhe kanë botuar po aty veprat e

vetë. E destinacioni ka qenë gjithsesi në tjetër drejtë: areali kulturor i Veriut katolik shqiptar".



Nadin (2012). Të dy vijin në përfundimin e vendndodhja e Buzukut, përkatesisht vëtë i bominit të "Mesharit" do kërkuar jashët hapësirës kompakte shqipfolëse, pas gjise në Venedig. Pa dashur të vë në pikëpyetje ndjenjat atdhetare të Buzukut, lejohem gjithsesi të pikëpërfshirës të paktën vendin e kësaj qyteti që nuk e kishte qëndruar që të gjithë tilla. Ngana tjetër nuk kemi arsyë të vëmë të dyshim që kopje të këtij libri i keni qarkulluar në radhët e klerit shqiptar në Shqipëri me u marrë sot konkretisht me prurjet dhe pozitivisht.

Shqipëri, Kosovë e gjetje. Të mos harrojmë se edhe autorë të mëvonshëm bëhet shqip si Budi, Bardi, Bogdani, Kazazi, Radovani, Guagliata, Basile, Radoja, Logoreci etj. i janë drejtuar Italisë, kur kanë dashur të botojnë dhe kanë botuar po aty veprat e veta. E destinacioni ka qenë gjithsesi në tjetër drejtë: areali kulturor i Veriut katolik shqiptar".

Shumë interesante është ndërrhyra juaj në debatin shkencor me Schmitt, ku ju e këshilloni që të futet në laboratorin sacrë të filologut. Cfarë dëmi i kanë bërë albanologjisë shqiptare teza e tij për projardhjen etniko-gjuhësore së Skënderbeut?

"Albanologjisë shqiptare apo të huaj, parë fushës sonë kompleksë në terësinë e saj, nuk i bën dëm një tezë a një tjetër që hidhet në debatin shkencor-intellektual. Për më tepër, në rastin tonë nuk kemi të bëjmë aspak me një tezë apo mendim original. Mjafton të përmend këtu apologjinë e Frang Bardhit, të botuar qysh më 1636, i cili i kundervihet atëbotë me maturinë e një intellektuali të formuar i pëshkujtë këtë Bosnjës lidhur me të ashtuquajturën origininë sllave të heroit tonë kombëtar. Studiuai që ju përmendët është ndër të fundit që mëton vetëm origininë shqiptare të Gjergj Kastriotit, duke hamendësuar origininë sllave deri greke të Derës së Kastriotëve, i nisur sipas rastit nga denduria e emrit/Ivan/ e të atë dokumentacionin e kanclerive sllave, ose nga burimi i apelativit /kasta-/ dhe i prapa shqiptesë greke /-iot/- që shfaqet te emri i familjes. Në këtë rast nuk është marrë parasysh realiteti gjuhësor-antrropologjji shqiptar e aq më pak vëtë kumi i Gjergjut tonë në korrespondencën e vet, ku përmend jo pa qenë krenar prejardhjen e tij epirote, ashtu siq ishtë bërë zakon në rrëthet intellektuale vendase dhe të huaja të kohës për t'u identifikuar lavdinë e dikurshme të shqiptarëve si popull antiqit të Ballkanit. Reagimi qytetar do të ishtë shumë më i madh, sikur edhe emri i Gjergjut tonë të zëvendësohej me vargjantin sllav Gjorgje. Deri aty ky autor nuk shkon e kjo është vërtet për t'u përshtondur. Gjithsesi, i patologës së agresivitetit ekstremit një prurjeve të elitës intellektuale shqiptare në periudhën e Dullës, duke e klasifikuar të tënë en bloc si hoxhiste. Dëmin më të madhi unë e shoh pikërisht këtu, bash në këtë mënyrë komportimi intellektual me mungesa të theksuarë të etikës profesionale. Më fort se sa albanoalogjisë në terësinë saj, i takon albanoalogjisë shqiptare në Shqipëri me u marrë sot konkretisht me prurjet dhe pozitivisht.



Vijon në faqen 20

